

**PAKETA FISKALE PËR TAKSAT DHE TARIFAT**  
**VENDORE**  
**PËR VITIN 2025**  
**BASHKIA PËRMET**

**1.TATIM MBI TE ARDHURAT PERSONALE**

Të ardhurat nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale vilen nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve dhe i transferohen pushtetit vendor ne forme transferte.

Te ardhura nga “ Tatimi Mbi Te Ardhurat Personale “	2, 000,000 leke
---	-----------------

**2.TAKSA MBI PASURINE E PALUAJTSHME**

**2.1: TAKSA MBI NDERTESAT**

1.Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe.

2. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

3. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

4.Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.

**5.Perjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:**

- a) pronat e shtetit dhe të njëjësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- ç)banesat sociale në pronësi të bashkive;
- d) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;

**dh)** ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;

**e)** strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtes të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”;

**ë)** ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/ pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë ,ose dhe me persona në ngarkim të tyre ,që janë të paaftë për punë;

**f)** ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;

**g)** ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore ,të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse;

**gj)** Ne qofte se ndërtesa demtohet nga forca madhore perjashtohet nga taksa e ndërtesës me 75% e vleres, dhe ne qofte se ndërtesa tjetërsohet ose zhduket gjate vitit detyrimi llogaritet me periudhen e te qenit pronar;

### **Baza e taksës**

Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Këshilli i Ministrave, në bazë të vjetërsisë së ndërtesës, mund të specifikojë nënkategori përkatëse.

“Ndërtesë”, objekti/objektet e ndërtuara mbi/nën sipërfaqen e tokës ose të lidhura me tokën dhe që përfaqëson një strukturë ndërtimore me një ose më shumë njësi pronësore, e cila është objekt i taksës mbi ndërtesën sipas përcaktimit të dhënë në ligj ( edhe strukturat provizore).

### **Shkalla e taksës**

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:

- a) 0,05 % për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b) 0,2 % për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- c) 30 % e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

### **Informacioni lidhur me taksën mbi ndërtesën**

Këshilli i Ministrave përcakton rregulla në lidhje me:

- a) natyrën dhe prioritetin e informacionit që do të përdoret në lidhje me përcaktimin e bazës së taksës mbi ndërtesat, në raste mospërputhjes të informacionit të marrë nga burime të ndryshme;
- b) prioritetin e të dhënave që do të përdoren në lidhje me vlerën e tatueshme.

### **Përgjegjësitë e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë**

Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë:

a) menaxhon regjistrin qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale);

b) udhëheq, nga pikëpamja metodologjike, në lidhje me administrimin e taksës mbi pasuritë e paluajtshme; c) përcakton nivelin e vlerësuar të taksës së pasurisë së paluajtshme për ndërtesat, si dhe detyrimin e taksës së pronës, me metoda alternative të vlerësimit.

Këshilli i Ministrave vendos kritere dhe rregulla në lidhje me procedurat dhe elementet që përdoren për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.

### **Përgjegjësitë e njësisë së vetëqeverisjes vendore**

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore është autoriteti përgjegjës për administrimin e taksës mbi ndërtesat nën juridiksionin e saj, përmes ushtrimit të funksioneve të mëposhtme:

a) mbledhjen dhe menaxhimin e informacioneve mbi ndërtesën për qëllime fiskale;

b) përditësimin e të dhënave të regjistrit qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale);

c) mbledhjen me forcë të detyrimeve të taksës mbi ndërtesën;

ç) korrigjimin e të dhënave në lidhje me llogaritjen e taksës, në rastet e saktësimit të informacionit për sipërfaqen, vendndodhjen zonale, çmimet e tregut etj;

d) shqyrtimin e ankimit administrativ të taksapaguesve.

2. Të ardhurat e mbledhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme derdhen për llogari të buxhetit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, dhe përdoren në përputhje me ligjin “Për financat e vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë.

- Qyteti i Përmetit së bashku me Njësitë Administrative të trajtohen si një zonë për efekt taksimi duke marrë për referencë çmimin mesatar të ndërtesave që përdoren për qëllime banimi për qytetin e Përmetit ( 37000 lekë / m<sup>2</sup>)sipas VKM nr.132 datë 07.03.2018 .

### **2.2:TAKSA MBI TOKEN BUJQESORE**

<b>Nr.</b>	<b>Klasifikimi sipas kategorise se tokes</b>	<b>Leke/ha/vit</b>
1	Kategoria e peste	1,000
2	Kategoria e gjashte	1,000
3	Kategoria e VII - X	1,000

- Klasifikimi sipas kategorive te tokes bujqesore eshte bere nga strukturat e Ministrise se Bujqesise dhe Ushqimit.
- Baza e taksës mbi token bujqesore është sipërfaqja e tokës bujqesore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja në pronësi të taksapaguesit përcaktohet sipas dokumenteve që e vertetojnë këtë pronësi.
- Detyrimi për taksën mbi token bujqesore është vjetor.

- *Struktura e ngarkuar per vjeljen e taksës mbi token bujqësore është struktura pergjegjese ne Njesite Administrative.*
- Përrjashtohen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

### **2.3:TAKSA MBI TRUALLIN( JO HAPESIRË PUBLIKE )**

*Taksa mbi truallin është :*

- ✓ **0.28 lekë/ m<sup>2</sup>** për qëllime banimi nga individë
- ✓ **15 lekë/m<sup>2</sup>** për qëllime biznesi
- Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli.
- Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.
- *Struktura e ngarkuar per vjeljen e taksës mbi truallin është Sektori i Tatim Taksave, Aseteve dhe Licencave*

### **3.TAKSA E FJETJES NE HOTEL**

<b>Nr.</b>	<b>Baza e taksës</b>	<b>Niveli</b>
1	Hotel me 4-5 yje	<b>105 lekë/natë</b> qëndrimi/ person
2	Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin	<b>35 lekë/natë</b> qëndrimi/person

- Me “hotel” kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.
- Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel, për person.
- Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.
- *Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Sektori i Tatim - Taksave ,Aseteve dhe Licencave dhe Njësitë Administrative.*

### **4.TAKSA E NDIKIMIT NE INFRASTRUKTURE NGA NDERTIMET E REJA**

**1.**Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

**2.**Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 (katër) për qind të çmimit të shitjes për metër katror.

- Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncesionare, e cila prek banesat ekzistuese. Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit.
- Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së ndërtimeve për qëllime banimi apo të njërive të tregtimit dhe shërbimit. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të nxjerra me akt të Këshillit të Ministrave.

**3.**Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe:

a) për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, të bujqësisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 3 (tre) për qind e vlerës së investimit.

b) për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, të aeroporteve, të tuneleve, të digave, të ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0.1 (zero pikë një) për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.

c) për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0.5 (zero pikë pesë) për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi.

d) për ndërtesat ,që destinohen për qëllime banimi në zonat malore ,taksa e ndikimit në infrastrukturë është 3 ( tre) përqind e vlerës së investimit.

**4.** Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet, për çdo rast, për llogari të bashkisë, që mbulon territorin ku do të bëhet investimi.

**5.** Nëse objekti, për të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës bashki.

**6.***Përfshihen* nga pagesa e kësaj takse investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese “Hotel/Resort me pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e

fushës së turizmit dhe që janë mbajtes të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”.

7.Përfshihen nga pagesa e kësaj takse edhe investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.

*Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Urbanistika në bashkëpunim me Njësitë Administrative.*

## **5.TAKSA MBI KALIMIN E DREJTËS SE PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME**

Nr	Kategoritë e ndërtesave	Niveli i miratuar Qyteti Permet	Lekë/m <sup>2</sup>
			Njesite Administrative
1	Ndërtesa banimi	100	100
2	Ndërtesa të tjera për tregëti e shërbime	300	300
3	Ndërtesa të tjera	200	200

- Taksa mbi kalimin e se drejtes se pronesise per pasurite e paluajtshme vendoset per ndertesat dhe te gjitha pasurite e paluajtshme ne çastin e kalimit te se drejtes se pronesise mbi to.
- Baza e takses mbi kalimin e se drejtes se pronesise per pasurite e paluajtshme eshte siperfaqja e ndertimit, pronesia e se ciles transferohet.
- Baza e takses per kalimin e se drejtes se pronesise per pasurite e tjera te paluajtshme eshte vlere e shitjes se tyre. Niveli i takses caktohet ne perqindje dhe niveli tregues i takses eshte 2 % .
- Agjent tatimor per vjeljen e takses mbi kalimin e se drejtes se pronesise per pasurite e paluajtshme eshte Zyra Vendore e Regjistrimit te Pasurise se Paluajtshme e cila perfton 3% te shumes se arketuar.

### **Afatet e pageses**

- Taksa paguhet nga personi, qe kalon te drejten e pronesise mbi pasurine e paluajtshme, para kryerjes se rregjistrimit, ne perputhje me aktet ligjore ne fuqi.

## **6.TAKSA E TABELËS**

Kategoritë	Niveli i taksës së tabelës
------------	----------------------------

<p><b>1. Taksë tabelle për qëllime identifikimi të trupëzuara ose jo , brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoren për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve( ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit)</b></p> <p><b>a)deri në 2 m<sup>2</sup></b>  <b>b)mbi 2 m<sup>2</sup> deri 10m<sup>2</sup></b>  - e thjeshtë( pa ndriçim)  -me ndriçim të thjeshtë  -elektronike</p> <p><b>c)mbi 10 m<sup>2</sup> deri 20 m<sup>2</sup></b>  - e thjeshtë( pa ndriçim)  -me ndriçim të thjeshtë  -elektronike</p> <p><b>d)mbi 20 m<sup>2</sup> deri 40 m<sup>2</sup></b>  - e thjeshtë( pa ndriçim)  -me ndriçim të thjeshtë  -elektronike</p> <p><b>e)mbi 40 m<sup>2</sup></b>  - e thjeshtë( pa ndriçim)  -me ndriçim të thjeshtë  -elektronike</p>	<p>0 lekë/m<sup>2</sup>/vit</p> <p>7,000 lekë/m<sup>2</sup>/vit</p> <p>11,500 lekë/m<sup>2</sup>/vit</p> <p>15,000 lekë/m<sup>2</sup>/vit</p> <p>5,950 lekë/m<sup>2</sup>/vit</p> <p>9,775 lekë/m<sup>2</sup>/vit</p> <p>12,750 lekë/m<sup>2</sup>/vit</p> <p>3,850 lekë/m<sup>2</sup>/vit</p> <p>6,325 lekë/m<sup>2</sup>/vit</p> <p>8,250 lekë/m<sup>2</sup>/vit</p> <p>2,800 lekë/m<sup>2</sup>/vit</p> <p>4,600 lekë/m<sup>2</sup>/vit</p> <p>6,000 lekë/m<sup>2</sup>/vit</p>
<p><b>2. Taksë tabelle për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim</b>  - Tabela identifikuese</p>	<p>120 lekë/m<sup>2</sup>/vit</p>
<p><b>3. Taksë tabelle për qëllime reklamimi e lëvizshme e palëvizshme deri në tavanin maksimal 35 m<sup>2</sup></b></p>	

- E thjeshtë( me /pa ndriçim )	13,500 lekë/m <sup>2</sup> /vit
- Elektronike	27,000 lekë/m <sup>2</sup> /vit
<b>4.Taksë tabelle në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese ,banderola etj</b>	
- Të të gjitha llojeve dhe përmasave	1,000 leke/m <sup>2</sup> /ditë

**1.** Taksa e tabelës zbatohet për të gjitha subjektet, të cilët vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendndodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendndodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private.

**2.** Për qëllime të zbatimit të këtij ligji, tabelat kategorizohen në:

a) Tabelë për qëllime identifikimi të veprimtarisë së subjektit, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve. Në të tilla tabela shënohet emri ose logoja dhe/ose veprimtaria e subjektit. Në rastin e përdorimit të më shumë se një tabelle identifikuese, vetëm njëra do të konsiderohet e tillë.

b) Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim. Këto tabela shërbejnë vetëm si tabela orientuese dhe vendosen jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti, për orientimin e klientelës apo të publikut drejt vendndodhjes së veprimtarisë së subjektit.

c) Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme ose e palëvizshme, e vendosur në pamje ballore ose jo ballore në vendin ku zhvillohet veprimtaria e subjektit, ose në hapësira të përbashkëta në qendrat tregtare, ose në hapësira të tjera publike apo private, si: tarraca, lozha, ballkone, fasada, trotuare, shtylla, mbajtëse ajrore mbi pjesë të rrugëve qytetase apo kombëtare etj., që kanë përmbajtje reklamimi për vete apo të tretët dhe që shërben si reklamë për të njoftuar, për të tërhequr vëmendjen ose për të joshur blerësit.

d) Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.

**3.** Taksa e tabelës është taksë vjetore. Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj., për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejes së dhënë nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

**4.** Tabela përmban shkronja, logo, simbole apo figura, që mundësojnë identifikimin e veprimtarisë së taksapaguesit apo që shërbejnë për qëllim orientimi, reklamimi ose ekspozimi. Si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja në metër katror që zë tabela në të gjithë shtrirjen e saj. Në rastin kur tabela përbëhet vetëm nga shkronja të veçuara, simbole, logo apo figura të vendosura, të gdhendura apo të pikturuara mbi një sipërfaqe ekzistuese, si: mur, fasadë



e jashtme e çdo lloji, shtyllë, kolonë, apo të ngjashme me to, dhe jo nga një sipërfaqe e vetme e shtrirë e shkruar, e stampuar apo e pikturuar brenda saj, e cila vendoset mbi një sipërfaqe ekzistuese, si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja që zënë të gjitha shkronjat, figurat, logot dhe simbolet që formojnë tabelën.

Kur në sipërfaqen e tabelës identifikuese përfshihen edhe shkronja, simbole dhe figura për qëllime reklamimi të një apo më shumë produkteve apo shërbimeve që furnizohen nga vetë njësia, ku është vendosur tabela, kjo tabelë vlerësohet si tabelë identifikuese dhe taksa llogaritet për këtë kategori tabelle. Në rast të kundërt, tabela vlerësohet si tabelë reklamimi dhe taksa llogaritet për tabelën për qëllime reklamimi.

Në rast të përdorimit nga taksapaguesi të më shumë se një tabelle identifikuese, përveç atyre orientuese, vlerësohet si tabelë identifikuese vetëm ajo tabelë që është e trupëzuar ose jo në njësinë apo brenda territorit ku ushtrohet veprimtaria e taksapaguesit, ose që ndodhet më pranë njësisë, ose vetëm një nga tabelat, kur ka më shumë se një të tillë në njësinë apo territorin ku ushtrohet veprimtaria e tij. Çdo tabelë tjetër e tillë konsiderohet si tabelë për qëllime reklamimi dhe taksa llogaritet dhe paguhet për këtë kategori tabelle.

- *Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Sektori I Tatim – Taksave, Aseteve dhe Licencave në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës dhe Njësitë Administrative.*
- Per tabelat reklamuese, ngarkohet Drejtoria e Urbanistikës që të leshojë lejet për vendosjen e tabelave reklamuese ku specifikohet vendndodhja dhe sipërfaqja e caktuar .

Taksa paguhet brenda datës 30 Prill të vitit fiskal dhe për subjektet e regjistruar rishtazi, në momentin e regjistrimit apo të kryerjes së aktivitetit.

## **7.TAKSA E RREGJISTRIMIT TE PERVITSHEM TE MJETEVE TE TRANSPORTIT RRUGOR**

Kjo Takse mbledhet nga agjenti tatimor DPSHTRR i cili mban një komisionin prej 5 (pesë)% të totalit mujor të të ardhurave .

### **Agjenti tatimor**

Agjent tatimor është Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Gjirokaster dhe të ardhurat ndahen:

- A .Bashkia Permet **25 %**
- B .Buxheti i Shtetit **75 %**

### **Afati i pageses**

Afati per shlyerjen e ketij detyrimi eshte momenti i kryerjes se kontrollit teknik vjetor brenda vitit. Te ardhurat derdhen per llogari te Bashkise nga DSHTRR – ja Gjirokaser brenda dates 15 te çdo muaji.

### **Menyra e pageses**

Taksa paguhet e plote edhe per mjetet qe rregjistrohen per here te pare pavaresisht nga data e rregjistrimit dhe eshte e vlefeshme per 365 dite.

## **8.TË ARDHURA PJESORE NGA TAKSA E RENTËS MINERARE**

Baza e kësaj takse janë burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin. Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka.

### **Afati i pageses**

Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare.

### **Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës**

Struktura e mbledhjes e kësaj takse është Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor, Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit, (5%) e të ardhurave të realizuara nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë Përmet ne llogarinë e degës së thesarit.

## **TARIFAT VENDORE**

<b>I</b>	<b><u>TARIFAT VENDORE</u></b>	<b><u>N.J.A PERMET</u></b>
<b>A</b>	<b><u>TARIFE PASTRIMI</u></b>	
	➤ <b><u>PER POPULLATEN</u></b>	<b>2,400 lekë/vit/familje</b>
	➤ <b><u>PER SUBJEKTET E BIZNESIT TE VOGEL</u></b>	
	-Tregeti ushqimore, mish,fruta-perime	16,900 lekë/vit
	-Tregeti artikuj industrial	10,000 lekë/vit
	-Bar-kafe (vetëm bar-kafe) – Zona I	20,000 lekë/vit
	-Bar-kafe (vetëm bar-kafe) – Zona II	15,000 lekë/vit
	-Bar-kafe, restorant	25,000 lekë/vit
	-Fast-food, mëngjesore	20,000 lekë/vit
	-Hotel	19,500 leke/vit
	-Guest House	9,100 leke/vit
	-Shërbime, artizane	9,100 lekë/vit
	-Servise	
	• Servise elektronike dhe elektroshtepiake	9,100 leke/vit

• Servis makinash	20,000 lekë/vit
• Gomisteri	20,000 lekë/vit
<i>-Prodhim</i>	
• Prodhim ushqimore (furra buke, pasticeri)	22,000 lekë/vit
• Prodhim ushqimore (gliko, kantine vere)	25,000 lekë/vit
• Prodhim Industrial ( dru alumini, perpunim druri)	22,000 lekë/vit
• Prodhim Industrial (mermer )	25,000 lekë/vit
• Prodhim i bimeve medicinale	30,000 lekë/vit
-Shoqëri Sigurimesh	23,400 lekë/vit
-Bilardo, kalçeto	15,600 lekë/vit
<i>-Profesionet e lira</i>	
• Dentist	10,000 lekë/vit
• Farmacist	15,000 lekë/vit
• Laborator mjekesor	10,000 lekë/vit
• Klinike mjekesore	10,000 lekë/vit
• Avokat , jurist	15,000 lekë/vit
• Kontabilist	15,000 lekë/vit
<i>-Transport:</i>	
• Mallrash	7,800 lekë/vit
• Udhetarësh me mjet 8+1	7,800 lekë/vit
• Udhetarësh me mjet 4+1 (taksi)	3,250 lekë/vit
-Supermarkete dhe tregeti me shumice	35,000 lekë/vit
-Tregje private fruta-perime	35,000 lekë/vit
-Tregje private artikuj industrial	35,000 lekë/vit
-Tregje te perziera (fruta-perime dhe artikuj industrial)	35,000 lekë/vit
-TV –Lokal (vendor)	15,600 lekë/vit
-Subjekte shërbimi varroshe	15,600 lekë/vit
➤ <b><u>PER SUBJEKTET E BIZNESIT TE VOGEL ME TVSH</u></b>	
-Prodhuesit	40,000 lekë/vit
-Karburantet	70,000 lekë/vit
-Tregeti dhe sherbime	40,000 lekë/vit
-Shoqeri transporti	45,000 lekë/vit
-TV Kabllor	70,000 lekë/vit
-Farmaci,Laborator Mjekesor,Klinik Mjekesore,Dentist	20,000 lekë/vit
-Fondacione te ndryshme	37,000 lekë/vit
-Noter	25,000 lekë/vit
-Sherbime elektronike	40,000 lekë/vit
-Fasoneri	120,000 lekë/vit
-Shkolla private	37,000 lekë/vit
-Ndertues dhe prodhues inerte ( perpunim gurri )	80,000 lekë/vit
➤ <b><u>PER SUBJEKTET E BIZNESIT TE MADH</u></b>	
-Prodhuesit	97,500 lekë/vit
-Karburantet	97,500 lekë/vit
-Bankat	170,000 lekë/vit
-Ndertues dhe prodhues inerte ( perpunim gurri )	113,100 lekë/vit
-Tregeti dhe sherbime	48,100 lekë/vit

	-Shoqeri transporti	65,000 lekë/vit
	-TV Kabllor	97,500 lekë/vit
	-Farmaci,Laborator Mjekesor,Klinik Mjekesore,Dentist	25,000 lekë/vit
	-Fondacione te ndryshme	39,000 lekë/vit
	-Sherbime elektronike	48,100 lekë/vit
	-Fasoneri	150,000 lekë/vit
	-Shkolla private	40,300 lekë/vit
	➤ <b><u>INSTITUCIONE DHE ZYRA SHETETRORE</u></b>	
	-OSHEE	170,000 lekë/vit
	-Posta Shqiptare Sh.a	70,000 lekë/vit
	-Ujesjelles – Kanalizime Permet	65,000 lekë/vit
	-Albtelecom	117,000 lekë/vit
	-Nenstacioni elektrik ( OSSH )	45,500 lekë/vit
	-Drejtoria e Shendetit Publik	100,000 lekë/vit
	-Spitali Permet	100,000 lekë/vit
	-FSDKSH	52,000 lekë/vit
	-Komisariati i Policise	30,000 lekë/vit
	-Sigurimet shoqerore	39,000 lekë/vit
	-A.SH.K	50,000 lekë/vit
	-Gjykata	50,000 lekë/vit
	-Zyra e punes	30,000 lekë/vit
	-Zyra Vendore Arsimore	30,000 lekë/vit
	-Dega e thesarit	30,000 lekë/vit
	-Zyra e Tatim -Taksave	50,000 lekë/vit
	-DBU	50,000 lekë/vit
	-DPSHTRR	50,000 lekë/vit
	-Zyra Permbarimore	30,000 lekë/vit
	-Shoqëri Sigurimesh	30,000 lekë/vit
	-Zyra e peshmatjes dhe kalibrimit	30,000 lekë/vit
	-Agropika	30,000 lekë/vit
	-INSTAT	30,000 lekë/vit
<b>B</b>	<b><u>TARIFE GJELBERIMI</u></b>	
	➤ <b><u>PER POPULLATEN</u></b>	<b>200 lekë/vit/familje</b>
	➤ <b><u>PER SUBJEKTET E BIZNESIT TE VOGEL</u></b>	
	-Tregeti ushqimore, mish, fruta-perime	2,200 lekë/vit
	-Tregeti artikuj industrial	2,200 lekë/vit
	-Bar-kafe (vetëm bar-kafe)	2,200 lekë/vit
	-Bar-kafe, restorant, fast-food, mëngjesore	2,200 lekë/vit
	-Hotel	2,200 leke/vit
	-Guest House	0 lekë/vit
	-Shërbime, artizanë	2,200 lekë/vit
	-Servise	
	• Servise elektronik dhe elektroshtepiake	2,200 lekë/vit
	• Servis makinash	2,200 lekë/vit
	• Gomisteri	2,200 lekë/vit
	-Prodhim	
	• Prodhim ushqimore (gliko, furre buke, kantina vere, pasticeri)	2,200 lekë/vit
	• Prodhim Industrial ( dru alumini, perpunim druri, mermer )	2,200 lekë/vit

• Prodhim i bimeve medicinale	2,200 lekë/vit
-Shoqëri Sigurimesh	6,000 lekë/vit
-Bilardo, kalçeto	2,200 lekë/vit
-Profesionet e lira	2,200 lekë/vit
-Transport:	
• Mallrash	2,200 lekë/vit
• Udhetarësh me mjet 8+1	2,200 lekë/vit
• Udhetarësh me mjet 4+1 (taksi)	2,200 lekë/vit
-Supermarkete dhe tregeti me shumice	6,000 lekë/vit
-Tregje private fruta-perime	2,200 lekë/vit
-Tregje private artikuj industrial	2,200 lekë/vit
-Tregje te perziera (fruta-perime dhe artikuj industrial)	2,200 lekë/vit
-TV –Lokal (vendor)	2,200 lekë/vit
-Subjekte shërbimi varroshe	2,200 lekë/vit
➤ <b><u>PER SUBJEKTET E BIZNESIT TE VOGEL ME TVSH</u></b>	
-Prodhuesit	5,000 lekë/vit
-Karburantet	5,000 lekë/vit
-Tregeti dhe sherbime	5,000 lekë/vit
-Shoqeri transporti	8,000 lekë/vit
-TV Kabllor	5,000 lekë/vit
-Fondacione te ndryshme	7,000 lekë/vit
-Farmaci,Laborator Mjekesor,Klinik Mjekesore,Dentist	5,000lekë/vit
-Sherbime elektronike	5,000 lekë/vit
-Noter	4,000 lekë/vit
-Fasoneri	8,000 lekë/vit
-Shkolla private	5,000 lekë/vit
-Ndertues dhe prodhues inerte ( perpunim gurri )	12,000 lekë/vit
➤ <b><u>PER SUBJEKTET E BIZNESIT TE MADH</u></b>	
-Prodhuesit	6,000 lekë/vit
-Karburantet	6,000 lekë/vit
-Tregeti dhe sherbime	6,000 lekë/vit
-Shoqeri transporti	11,000 lekë/vit
-Bankat	50,000 lekë/vit
-TV Kabllor	6,000 lekë/vit
-Fondacione te ndryshme	10,000 lekë/vit
-Farmaci,Laborator Mjekesor,Klinik Mjekesore,Dentist	6,000 lekë/vit
-Sherbime elektronike	6,000 lekë/vit
-Fasoneri	11,000 lekë/vit
-Shkolla Private	6,000 lekë/vit
-Ndertues dhe prodhues inerte ( perpunim gurri )	20,000 lekë/vit
➤ <b><u>INSTITUCIONE DHE ZYRA SHTETRORE</u></b>	
-OSHEE	50,000 lekë/vit
-Posta Shqiptare sh.a	15,000 lekë/vit
-Ujesjelles – Kanalizime Permet	24,000 lekë/vit
-Albtelecom	25,000 lekë/vit
-Drejtoria e Shendetit Publik	20,000 lekë/vit
-Nenstacioni Elektrik ( OSSH )	10,000 lekë/vit
-Spitali Permet	20,000 lekë/vit

	-FSDKSH	10,000 lekë/vit
	-Komisariati i Policise	10,000 lekë/vit
	-Sigurimet Shoqerore	10,000 lekë/vit
	-A.SH.K	20,000 lekë/vit
	-Gjykata	20,000 lekë/vit
	-Zyra e punes	10,000 lekë/vit
	-Zyra Vendore Arsimore	10,000 lekë/vit
	-Dega e Thesarit	10,000 lekë/vit
	-Zyra e Tatim - Taksave	20,000 lekë/vit
	-DBU	20,000 lekë/vit
	-DPSHTRR	20,000 lekë/vit
	-Zyra Permbarimore	20,000 lekë/vit
	-Shoqëri Sigurimesh	15,000 lekë/vit
	-Zyra e peshmatjes dhe kalibrimit	20,000 lekë/vit
	-Agropika	20,000 lekë/vit
	-INSTAT	20,000 lekë/vit
<b>C</b>	<b><u>TARIFE NDRICIMI</u></b>	
	➤ <b><u>PER POPULLATEN</u></b>	<b>800 lekë/vit/familje</b>
	➤ <b><u>PER SUBJEKTET E BIZNESIT TE VOGEL</u></b>	
	-Tregeti ushqimore, mish, fruta-perime	4,000 lekë/vit
	-Tregeti artikuj industrial	4,000 lekë/vit
	-Bar-kafe (vetëm bar-kafe)	4,000 lekë/vit
	-Bar-kafe, restorant, fast-food, mëngjesore	4,000 lekë/vit
	-Hotele	4,000 lekë/vit
	-Guest House	0 lekë/vit
	-Shërbime, artizanë	4,000 lekë/vit
	-Servise	
	• Servise elektronik dhe elektroshtepiake	4,000 lekë/vit
	• Servis makinash	4,000 lekë/vit
	• Gomisteri	4,000 lekë/vit
	-Prodhim	
	• Prodhim ushqimore (gliko, furre buke, kantina vere, pasticeri)	4,000 lekë/vit
	• Prodhim Industrial ( dru alumini, perpunim druri, mermer )	4,000 lekë/vit
	• Prodhim i bimeve medicinale	4,000 lekë/vit
	-Shoqëri Sigurimesh	4,000 lekë/vit
	-Bilardo, kalçeto	4,000 lekë/vit
	-Profesionet e lira	4,000 lekë/vit
	-Transport:	
	• Mallrash	4,000 lekë/vit
	• Udhetarësh me mjet 8+1	4,000 lekë/vit
	• Udhetarësh me mjet 4+1 (taksi)	4,000 lekë/vit
	-Supermarkete dhe tregeti me shumice	4,000 lekë/vit
	-Tregje private fruta-perime	4,000 lekë/vit
	-Tregje private artikuj industrial	4,000 lekë/vit
	-Tregje te perziera (fruta-perime dhe artikuj industrial)	4,000 lekë/vit
	-TV –Lokal (vendor)	4,000 lekë/vit
	-Subjekte shërbimi varroshe	4,000 lekë/vit

	<b>➤ PER SUBJEKTET E BIZNESIT TE VOGEL ME TVSH</b>	
	-Prodhuesit	6,000 lekë/vit
	-Karburantet	6,000 lekë/vit
	-Tregeti dhe sherbime	6,000 lekë/vit
	-Shoqeri transporti	6,000 lekë/vit
	-TV Kabllor	6,000 lekë/vit
	-Fondacione te ndryshme	9,000 lekë/vit
	-Farmaci,Laborator Mjekesor,Klinik Mjekesore,Dentist	6,000 lekë/vit
	-Sherbime elektronike	6,000 lekë/vit
	-Noter	5,000 lekë/vit
	-Fasoneri	6,000 lekë/vit
	-Shkolla private	6,000 lekë/vit
	-Ndertues dhe prodhues inerte ( perpunim gurri )	6,000 lekë/vit
	<b>➤ PER SUBJEKTET E BIZNESIT TE MADH</b>	
	-Prodhuesit	7,000 lekë /vit
	-Karburantet	7,000 lekë /vit
	-Tregeti dhe sherbime	7,000 lekë /vit
	-Shoqeri transporti	7,000 lekë /vit
	-Bankat	50,000 lekë/vit
	-TV Kabllor	7,000 lekë /vit
	-Fondacione te ndryshme	12,000 lekë/vit
	-Farmaci,Laborator Mjekesor,Klinik Mjekesore,Dentist	7,000 lekë/vit
	-Sherbime elektronike	7,000 lekë/vit
	-Fasoneri	7,000 lekë/vit
	-Shkolla Private	7,000 lekë /vit
	-Ndertues dhe prodhues inerte ( perpunim gurri )	7,000 lekë /vit
	<b>➤ INSTITUCIONE DHE ZYRA SHTETRORE</b>	
	-OSHEE	50,000 lekë/vit
	- Posta Shqiptare sh.a	15,000 lekë/vit
	- Ujesjelles – Kanalizime Permet	22,000 lekë/vit
	-Albtelecom	35,000 lekë/vit
	-Nenstacioni elektrik ( OSSH )	11,000 lekë/vit
	-Drejtoria e Shendetit Publik	30,000 lekë/vit
	-Spitali Permet	30,000 lekë/vit
	-FSDKSH	12,000 lekë/vit
	-Komisariati i Policise	12,000 lekë/vit
	-Sigurimet Shoqerore	12,000 lekë/vit
	-A.SH.K	20,000 lekë/vit
	-Gjykata	20,000 lekë/vit
	-Zyra e Punes	12,000 lekë/vit
	-Zyra Vendore Arsimore Permet	12,000 lekë/vit
	-Dega e Thesarit	6,000 lekë/vit
	-Zyra e peshmatjes dhe kalibrimit	10,000 lekë/vit
	-Agropika	10,000 lekë/vit
	-INSTAT	10,000 lekë/vit
	-Zyra e Tatim -Taksave	20,000 lekë/vit
	-DBU	20,000 lekë/vit
	-Shoqëri Sigurimesh	10,000 leke/vit
	-DPSHTRR	10,000 lekë/vit

	-Zyra Permbarimore	10,000 lekë/vit
	<i>Për arkëtimin e këtyre të ardhurave ngarkohet Sektori i Tatim – Taksave,Aseteve dhe Lincecave</i>	
